



**Për: Visar Duriqi**  
**Nga: Administrata Tatimore e Kosovës**  
**Qëllimi: Përgjigje**

**28.09.2012**

***Pyetje nga Qendra Kosovare për Gazetari Huluntuese***

1. Borxhi mbi 1.7 milionë euro i biznesit "COMPANY 21" SH.P.K. me nr Biznesi: 70124965 a është si rezultat i këtij veprimi të këtij biznesi, për ndërprerje të nxjerrjes së TVSH-së nga marketingu në periudhën 2001-2004 (diku rreth 700.000 euro borxh i parashikuar dhe ndëshkimet dikur mbi 1 milionë euro)?
2. Nëse po, cilat janë faktet e ATK-së kundër pretendimeve të "COMPANY 21" SH.P.K. se ATK-ja nuk mund të kërkojë borxhin më të vjetër se 6 vite?
3. Nëse borxhi prej mbi 1.7 milionë eurosh i "COMPANY 21" SH.P.K. nuk është si rezultat i këtij veprimi të këtij biznesi, për ndërprerje të nxjerrjes së TVSH-së nga marketingu në periudhën 2001-2004, cili është burimi i këtij borxhi?

-Dhe ndonjë sqarim që e shihni të arsyeshëm në këtë rast?

***Përgjigjet:***

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se bazuar në Ligjin Nr 03/L-222 - për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht nenin 84 që përcakton Konfidencialitetin e informatave tatimore, informatat e tilla konsiderohen konfidenciale, përveç nëse aplikohet paragrafi 3 i po të njëjtit nen, kur tatimpaguesi mund të lirojë çdo person nga detyrimi i konfidencialitetit. Lirimi i tillë duhet të jetë me shkrim dhe mund të kufizohet në dhënien e informatave të caktuara ose t'i shfrytëzojë për një qëllim të veçantë.

Ne si Administratë Tatimore, duke u bazuar në nenin e lartë cituar jemi të obliguar të japim informata vetëm për institucionet, të cilat janë të parapara me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

